



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

Zyra e Përsoneelit

Nr.03/224

Më:23/02/2012

Në mbështetje të dispozitave të nenit 11, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 15 dhe 17 të Rregullores Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëheqesi i Përsoneelit shpall:

K O N K U R S
Për plotësimin e vendit të lirë të punës

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGITHSHME

1.(Një) Mirëmbajtës i Kompleksit Memorial në fshatin Kleçkë.

Kushtet: Shkolla e Mesme.

Koeficienti: 5

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Kujdeset për mirëmbajtjen e Varrezave të Dëshmorëve.
- Kujdeset për pritjen dhe shoqërimin e personave të cilit do ti vizitojnë varrezat e Dëshmorëve.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës përcjellëse të kompleksit.
- Koordinon punët rreth aktiviteteve të Drejtorisë Komunale për Kulturë Rini dhe Sport, me rastet e kremtimeve të përvjetorëve që janë të ndërlidhura me këtë kompleks.
- Kujdeset për mbarëvajtjen e parkingut të kompleksit tek varrezat e Dëshmorëve në fshatin Kleçkë.

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në **Zyrën për pritjen e palëve** të KK- Malishevë. Aplikantët janë të obliguar që t'i parashtrojnë edhe këto dokumente: diplomën e shkollimit, Vërtetimin mbi përvojën në punë.

Konkursi do të mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së tij në të përditshmet:”**Koha ditore**” dhe “**Epoka e Re**” dhe në tabelë të shpalljeve të **KK- Malishevë**.

Për datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës dot njoftoheni me kohë.

Udhëheqësi i Personelit
Gani Bahtjaraj, jur.dipl.
